



Shyqyri Haxha
Palë ankuese

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. nr 2023/18: Ankesa e z. Shyqyri Haxha (Palë ankuese) kundër KTV

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 17 mars 2023 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese ndaj KTV-së lidhur me transmetimin e një kronike në lajmet qendrore të datës 3 mars 2023, me titull “*Ish-kryeshefi i PTK-së lirohet nga akuza për lidhje të kontratës së dëmshme.*”
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore, me datën 21 mars 2023 i ka dërguar shkresë KTV-së përmes të cilës ka kërkuar sqarim për ankesën e parashtruar.
4. KPM ka pranuar përgjigje nga KTV me datën 31 mars 2023, në të cilën theksohet se: “*Storia të cilës i referohet pala ankuese mbulon vendimin e Gjykatës Themelore (vendim që nuk është ende i plotfuqishëm) rreth akuzave për lidhje të kontratës së dëmshme nga ish-kryeshefi i PTK-së. Siç mund ta shihni më poshtë, ajo përmban deklaratat e Gjyqtarit të themelores, Sabit Sadikaj, të të akuzuarit Shyqyri Haxha dhe të ekspertit të telekomunikacionit, Ismet Hamiti. Deklarimet e z. Hamiti, për të cilat pala ankuese ka reaguar, nuk janë të reja. Ato janë deponuar në organet e drejtësisë si shkresa, janë bërë verbalisht në seanca gjyqësore, janë publikuar nëpër media në formë shkrimesh e intervistash. Z. Haxha mund ta padisë z. Hamiti për këto deklarata nëse Gjykata merr në të ardhmen një vendim të plotfuqishëm për rastin e tij, ngase janë organet e drejtësisë ato që hetojnë dhe japin fjalën e fundit dhe jo mediat. Storia e KTV-së ka bërë bashkë palët dhe ka transmetuar çka thonë ata. Nuk ka nxjerrë verdikt kush ka të drejtë e kush jo, nuk ka akuzuar as denigruar askënd. Sikur z. Haxha ashtu edhe z. Hamiti e kanë pasur çdoherë gjithë hapësirën e nevojshme në mediat e Kohës për ta thënë të vërtetën e tyre, dhe do ta kenë në të ardhmen ata dhe të tjerët.*”

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, përgjigjen e KTV-së, si dhe ka bërë monitorimin e kronikës në fjalë dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 4 prill 2023 ka gjetur se KTV nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 lidhur me pretendimet ankimore.
6. KPM me datën 7 prill 2023 i ka dërguar Palës ankuese përgjigje në ankesë me të cilën e ka njoftuar që mund ta shfrytëzojë të drejtën për reagim për të dhënë qëndrimin e tij në raport me kronikën dhe në bazë të nenit 7, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03, KTV është e obliguar që ta transmetojë atë reagim.
7. KPM me datën 7 prill 2023 ka pranuar përgjigje nga Pala ankuese lidhur me përgjigjen në ankesë të dërguar nga ana e KPM-së, në të cilën theksohet se: *Po ua ilustrim shkeljen që ta keni të qartë: Në minutën 1:33 të kronikës së KTV është deklarata ime në lidhje me çështjen, që është gjithçka në rregull deri këtu, mirëpo pas deklaratës time, televizioni fut në kronikë deklaratën e Ismet Hamitit, që hedh akuza të rënda ndaj meje dhe në këtë rast KTV nuk më ballafaqon me të fare. Me këtë veprim KTV ka shkelur Nenin 10, pikën 1, sepse nuk më është dhënë e drejta për t'iu përgjigjur akuzave. Po ashtu në këtë raportim KTV ka shkelur Nenin 6, pika 4, pasi që ka transmetuar akuza të një personi, por që nuk ka afruar asnjë fakt dhe në pikën 5 të nenit 6 specifikohet se “është obligim profesional të korrigohet çfarëdo informacioni i pa saktë.”*
8. KPM me datën 12 prill 2023 i ka dërguar Palës ankuese përgjigje përmes emailit ku i ka sqaruar se qëllimi i përgjigjes së dërguar ishte që të informohej për mundësinë e shfrytëzimit të të drejtës së reagimit për çështjen në fjalë. Ndërsa, sa i përket bazueshmërisë së pretendimeve ankimore do të njoftohet përmes vendimit të Komisionit të KPM-së, sapo ky organ të jetë funksional.

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura, ka konstatuar se KTV ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
10. KPM pretendimet e Palës ankuese i ka trajtuar në kuptimin e neneve të cilëve iu është referuar Pala ankuese: nenit 3, paragrafi 3, nenit 5, paragrafi 3, nenit 6, paragrafi 4 dhe nenit 7, paragrafi 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. Neni 3, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHMA-të sigurohen që materiali i cili mund të shkaktojë dëm, ose përbën shkelje, të justifikohet nga konteksti. Materialet e tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, gjuhën fyese, dhunën, seksin, dhunën seksuale, poshtërimin, ankthin, shkeljen e dinjitetit njerëzor, trajtimin ose gjuhën diskriminuese. Informacioni i duhur duhet gjithashtu të transmetohet aty ku do të ndihmonte në shmangien apo minimizimin e shkeljes”

Pala ankuese në Ankesë ka pretenduar se nga kronika në fjalë është fyer, poshtëruar dhe i është shkelur dinjiteti njerëzor, si dhe i është shkaktuar ankth. KPM gjen se ky pretendim

është i pa bazuar, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me një deklaratë të një eksperti të fushës që flet për rastin në fjalë. Shprehjet e përdoruar nga ana e tij nuk pasqyrojnë qëndrim editorial të OSHM-së, por janë vlerësime gjyquese të tij lidhur me këtë çështje. Pra, kronika si e tillë nuk ka synim ta fyej apo poshtëroj Palën ankuese, por ajo rithekson edhe njëherë qëndrimet dhe opinionet publike të ekspertit të fushës lidhur me ndërmarrjen publike dhe personat që e kanë menaxhuar atë, përfshirë edhe Palën ankuese.

12. Neni 5, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHMA-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paaftësi fizike ose mendore”

Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 5, paragrafi 3, ku Pala ankuese deklaroi se është përdorur gjuhë denigruese ndaj tij, KPM gjen se ky nen flet për gjuhën denigruese të përdoruar nga ana e OSHMA-ve ndaj individit apo grupit në baza të përkatësisë etnike, fetare, racore, gjendjes martesore, moshës dhe paaftësisë fizike apo mendore. KPM gjen se referenca në këtë nen është e gabuar, sepse asnjëherë përgjatë kronikës nuk përdoren shprehje gjuhësore denigruese në baza të përkatësisë së caktuar etnike, fetare, racore, gjendjes martesore, moshës dhe paaftësisë fizike apo mendore.

13. Neni 6, paragrafi 4, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Përderisa OSHMA-të janë të lira për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinion mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese”.

Për pretendimin e Palës ankuese për shkelje të nenit 6, paragrafi 4, për të cilin Pala ankuese ankohet për ofrim hapësire të opinionit të pa bazuar në fakte të z. Hamiti, KPM gjen se ky pretendim është kontradiktor, sepse sipas këtij neni opinionit nuk parashihet të jetë i bazuar në fakte, por ai mbart mendime, ide, besime, supozime, komente apo gjykime vlerësuese. Dhe opinionit i z. Hamiti është një vlerësim gjyqësor, që e balancon informacionin e kronikës nga gjykata. Edhe referenca në paragrafin 5 të këtij neni është jo e qëndrueshme, sepse askund në kronikë nuk thuhet se Pala ankuese është i fajshëm lidhur me rastin e Z-mobile, siç i referohet ai. Përkundrazi, kronika potencon se ai ishte shpallur i pafajshëm në këtë rast nga gjykata.

14. Neni 7, paragrafi 5, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Sulmet personale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në sulmet në ndershmerinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi, institucioni apo grupi të identifikuar, në çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin publik, janë të ndaluara”.

Për pretendimin e Palës Ankuese se Pala përgjegjëse ka shkelur nenin 7, paragrafi 5, duke lejuar z. Hamiti të bëjë sulme personale, KPM gjen se KTV nuk i referohet me emër, edhe

pse nënkuptohet se bëhet fjalë për Palën ankuese. Po ashtu, kemi të bëjmë me vlerësime gjyqësore dhe besime të z. Hamiti lidhur me ndershmërinë e Palës ankuese, Mirëpo, Pala ankuese ka ushtruar funksion të lartë publik në një ndërmarrje publike dhe proceset gjyqësore dhe gjithçka tjetër që lidhet me punën e kësaj ndërmarrjeje publike është interes publik dhe kjo e tejkalon aspektin personal të Palës ankuese, sepse lidhet me funksionet e tij publike. Edhe pretendimet për sulm në personin e Palës ankuese sipas nenit 7, paragrafi 7, Palës ankuese i është dhënë e drejta për përgjigje lidhur me rastin e tij në gjykatë. Mirëpo, pakënaqësia e Palës ankuese qëndron në faktin se z. Hamiti ka folur pas tij dhe ai nuk ka qenë në dijeni dhe në gjendje t'i demantojë. Pra, nuk ka pasur hapësirën e nevojshme t'i kundërshtojë faktet që z. Hamiti i ka bërë të ditura për publikun. KPM është bazuar në përgjigjen e KTV-së që ka shprehur se Pala ankuese ashtu edhe z. Hamiti e kanë pasur çdoherë gjithë hapësirën e nevojshme në mediat e Kohës për ta thënë të vërtetën e tyre, dhe me përgjigjen e dërguar e ka udhëzuar Palën ankuese që ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit.


15. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 lidhur me transmetimin e kronikës në lajmet qendrore të datës 3 mars 2023, me titull "*Ish-kryeshefi i PTK-së lirohet nga akuza për lidhje të kontratës së dëmshme.*"

Vendim

16. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 lidhur me transmetimin e kronikës në lajmet qendrore të datës 3 mars 2023, me titull "*Ish-kryeshefi i PTK-së lirohet nga akuza për lidhje të kontratës së dëmshme.*"

E drejta për ankesë

17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar



24. 11. 2023
Datë